



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

Drejtoria e Të Ardhurave Vendore, Lejeve dhe Licensave

(i) Misioni

Ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe në kohë për taksapaguesit, nëpërmjet manaxhimit të sistemeve të rregjistrimit të dhënies së informacionit, shpjegimit, llogaritjes së detyrimit, përshpejtimit dhe lehtësimit të procedurave për pagesat e taksave vendore për të gjitha subjektet taksapaguese që punojnë në bashkinë e Peqinit dhe në shërbim të Bashkisë Peqin”.

(ii) Detyrat

- a. Forcimi i disiplinës fiskale në zbatimin e drejtë, të ndershëm dhe eficient të procedurave tatimore, si mjet kryesor për reduktimin e evazionit fiskal dhe krijimin e një sistemi të drejtë tatimor.
- b. Krijimi i sistemeve dhe rrjeteve të informacionit dhe ofrimi i shërbimeve ndaj taksapaguesve nëpërmjet teknologjisë së informacionit, si dhe të shërbimit në një sportel. Informatizimi dhe lidhja në një rrjet të vetëm i të gjithë informacionit brenda territorit të Bashkisë Peqin (Struktura të Bashkisë, Njësitë Administrative, Bankat e nivelit të dytë etj.)
- c. Vendosja dhe zbatimi i rregullave transparente në rekrutimin, karrierën dhe zbatimin e masave disiplinore për punonjësit në përputhje me rregullat bazë të Shërbimit Civil.
- d. Edukimi fiskal i publikut dhe forcimi i marrëdhënieve me publikun taksapagues për rritjen e besueshmërisë ndaj administratës fiskale dhe zbatimin vullnetar të legjisllacionit tatimor. Për këtë do të iniciohen programe edukative si dhe do të prodhohen guida dhe materiale të tjera informative. Qytetarët dhe bizneset do të informohen për të drejtat dhe detyrimet e tyre tatimore.
- e. Harton dhe propozon për miratim politikat fiskale të Bashkisë.
- f. Harton projektin e paketës fiskale.
- g. Është përgjegjës për administrimin e procesit të parashikimit, evidentimit dhe vjeljes së të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

- 1) Evidenton të gjithë subjektet taksapagues, për këtë bashkepunon me drejtorinë rajonale tatimore Elbasan.
- 2) Përllogarit vlerën e taksave dhe tarifave vendore, që duhet të paguaje cdo subjekt dhe i kërkon atyre të paguajnë detyrimet.
- 3) Lëshon vertetimet për shlyerjen e detyrimeve fiskale vendore.
- 4) Propozon dhe kërkon marrjen e masave administrative, për personat dhe subjektet që nuk shlyejnë detyrimet fiskale vendore.
- 5) Bashkepunon me sektorin e policisë bashkiake për ekzekutimin e vendimeve për masat administrative.
- h. Bashkepunon me ndermarrjet, institucionet apo subjektet e tjera të percaktuara nga ligji si agjente tatimore për vjeljen e detyrimeve fiskale vendore.
- i. Raporton para Kryetarit të Bashkisë apo Keshillit Bashkiak për realizimin e të ardhurave nga taksat apo tarifave vendore.

j. Planifikon te ardhurat nga taksat apo tarifat vendore ne bashkepunim me sektoret perkates dhe i paraqet drejtorise se finances, projektin e te ardhurave nga taksat e tarifat vendore, per efekt te hartimit te projekt-buxhetit.

k. Kontrollon subjektet e ndryshme per lejet per ushtrim profesioni, regjistrimin e tyre dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale vendore.

l. Ne bashkepunim me drejtorine e finances dhe drejtori apo sektore te tjere ne Bashki, ben studime dhe analiza dhe i propozon Keshillit Bashkiak, vendosjen e taksave dhe tarifave vendore, sipas procedurave te caktuara ligjore.

m. Pergjigjet per planifikimin, projektimin, ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe rrjetit te tregtise ne territorin e bashkise

1) Planifikon ngritjen, shperndarjen e tregjeve dhe njesive tregtare sipas kategorive dhe shumlojshmerise se tyre (tregje me shumice ose pakice, tregje ushqimore ose industriale).
2) Bashkepunon me drejtori apo sektore te tjere per perfshirjen e tregjeve ne planet e zhvillimit te Bashkise.

3) Disiplinon dhe kontrollon veprimtarine e tregtise ambulante dhe merr masa ne bashkepunim me sektorin e policise bashkiake, per parandalimin e tregtise ne vendet e pa miratuara.

n. Administron tregjet e lira ne territorin e Bashkise.

1) Merr masa per funksionimin normal te tregjeve te lira ne territorin e Bashkise.

2) Kujdeset per mirembajtjen, pastrimin si dhe paisjen e tregjeve me infrastrukturen higjeno-sanitare te nevojshme.

3) Lidh kontrata me individe qe kerkojne te tregtojne ne ambjentet e tregjeve te lira dhe ben vjeljen e taksave te caktuara ne keto tregje.